

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: N.P.T. “Bajra” me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	02.11.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **01.11.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.P.T. “Bajra” me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** e pabazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.P.T. “Bajra” me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **27.10.2021**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **N.P.T. “Bajra”** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **27.10.2021**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **01.11.2021**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Sqarimi 1:

Kompania jonë ka bërë furnizime të suksesshme që arrijn vlerën 320,699.90 ku pjesa më e madhe i përkasin mekanizmit bujqësor duke arritur kështu edhe vlerën furnizuese të kërkuar në FDT. Ne, konsiderojm se furnizimi me kositese dhe pajisje të tjera i përkasin mekanizmit bujqësor dhe si të tilla nuk do të duhej të përjashtoheshin nga lista e furnizimeve. Një nga kërkesat e produkteve në DT ka qenë kositese rotative 135 (prandaj si e tille perputhet me furnizimet e bëra nga kontratat tona të kaluara me subjekte publike dhe private).

Bazuar në nenin Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale paragrafi 2.1. listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënen shkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;

Në oferten e dërguar për këtë tender, ne kemi bashkengjitur të gjitha referencat lidhur me furnizimet përkatese, dhe këtë e kemi dëshmuar me pagesa ashtu sic është kërkuar nga AK, prandaj, arsyetimi 1 për eliminim nuk qëndron dhe nuk pranohet nga ana jonë.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që në Dosjen e Tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (furnizim me mekanizëm bujqësor), dhe vlera e Referencave apo Procesverbaleve të dorëzuar nga ana juaj është: **176,192.90 €**, ku me formular: **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, jeni njoftuar, *duke cekur*:

Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (furnizim me mekanizëm bujqësor), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min.

LOT 1 232,500.00 Euro
LOT 2 255,000.00 Euro
LOT 3 303,500.00 Euro
LOT 4 262,500.00 Euro
LOT 5 189,500.00 Euro
LOT 6 32,500.00 Euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1: Lista e projekteve të kryera në lëmin e furnizimeve të natyrës së njëjtë (furnizim me mekanizëm bujqësore), të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar: Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në original, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca t ose procesverbali et e pranimit te mallit. (Nëse kontratat janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare e ndërkombëtare, atëherë ato duhet të dëshmohen me qarkullime bankare për atë kontratë - referencë - kontratës, bashkangjitur pagesën bankare).

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (furnizim me mekanizëm bujqësore), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca/t ose procesverbali/et e pranimit te mallit. Referenca/t ose procesverbali/et e pranimit te mallit për furnizimet të kryera në lëmin e furnizimeve të njëjta (furnizim me mekanizëm bujqësore), të dorëzuar nga ana juaj, janë në vlerë prej: 176,192.90 €, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

– Nuk e keni plotësuar këtë kriter sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Bazuar në tabelarin e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ në faqen 89 kemi shembullin se si duhet vepruar:

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
--	---	----

Në Listën e Kontratave të prezantuara janë edhe projektet sipas tabelës së mëposhtme, të cilat nuk janë të natyrës së njëjtë, në bazë Kërkesë nr. 1 të Kapaciteti teknik dhe profesional:

Furnizim me makina per pastrimin e dyshemese	22.12.2020	22.01.2021	8000.01€	Kuvendi Komunal Malisheve	enver.mazreku@rks-gov.net	+ 383 (0) 44 289 321
Furnizim me fryrëse ajri portative me motor me djegje benzinë për shuarjen e zjarreve fushore për BZP-Prishtinë	07.08.2019	07.09.2019	9,724.00€	Komuna e Prishtinës	Male.gashi@rks-gov.net	+383 (0) 44 124 256
Furnizim me mjete te punes per pastrimin e hapsirave gjelberuese publike ne territorin e Komunes se Fushe Kosoves	18.09.2020	18.10.2020	4,267.64€	Kuvendi Komunal Fushe Kosove	bedri.obertinca@rks-gov.net	038 200 40511 038 200 40512
Furnizim me pompa uji per zjarrefiksa	23.11.2020	23.12.2020	2,450.00€	Komuna e Kamenices	Prokurimi.kamenice@rks-gov.net	038/200-47-623

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Sqarim 2:

Bazuar në Nenin 59 të LPP-së, paragrafi 4, ku thuhet: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.... sqarojmë se nuk janë plotësuar kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit.

Kërkesa 2: Prezantimi i produkteve të ofruara me katalogë/broshura.

Sa i përketë prezentimit të produkteve të ofruar, ashtu si është kërkuar në dosjen e tenderit, ne kemi ofruar katalogun e pajisjeve së bashku me specifikat teknike të kërkuara të cilat plotësohen konform kërkesës së autoritetit kontraktues. Dhe secila specifike teknike është në përputhshmeri të plotë me DT.

Nëse një nga specifikimet apo paraqitjet e produkteve ka qenë i pamjaftueshëm atëherë ju si AK është dashur që konform RRUOPP nenin 39. Sqarimi i Tenderëve – RRUOPP Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu	Mund të kërkohej informata sqaruese	69
---	-------------------------------------	----



Neni 59. Paragrafi 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Për kundër kësaj, ne vendimin e AK është propozuar për shpërblym me kontratë nje Operator Ekonomik i cili nuk i plotëson kërkesat sipas dosjes së tenderit. Bazuar në kërkesat për DT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkohej Certifikata CE dhe Deklarata e Konformitetit të cilat OE i shpërblyer me kontratë **nuk i ka dorëzuar** për pozicionin 2 dhe 3 të Lot 5, respektivisht për pozicionin Grabuj me traka dhe pllug 5 brazdash. Prandaj me një vlerësim të tillë konfirmohet që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të Nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve pika 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që në Ofertën e juaj të dorëzuar, nuk keni bashkangjitur asnjë katalog nga prodhuesi, por vetëm i keni përshkruar Specifikat e Autoriteti Kontraktues.

Vlen të ceket se në ofertën e juaj të dorëzuar, Katalogu nuk përmbush as kërkesat minimale të kërkuara nga AK, pasi që ju kemi bere përshkrimin e specifikave, por me foto në katalog është vendosur diçka tjetër.

Si për shembull është kërkuar PLLUG 5 BRAZËSH, ndërsa në foto te bashkangjitur keni vendosur PLLUG 5 RENDORE, qe nuk korrespondon me specifikat e AK:

PLLUG



PLLUG 5 BRAZËSH
Numri i njesive 5 rende
Thellesia punuese 12 - 18 cm
Gjeresia punuese 150 cm
Distanca ndermjet rendeve deri ne 220 cm
Gjeresia punuese e kornizes 92 - 180 cm
Pesha 355 kg
Fuqia e kerkuar 25 kW



Ndërsa kërkesa e AK-së në Specifikat teknike është, *shih foto*:



PLLUG 5 BRAZËSH

Po ashtu me formular: **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, jeni njoftuar, duke cekur:

Kërkesa 2: Prezantimi i produkteve të ofruara me katalogë/broshura.

Dëshmia 2: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë broshura për produkte të ofruar duke e nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike.

- Katalogë/broshura e dorëzuara nuk janë dorëzuar sipas Kërkesës Nr. 2 të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit, tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT).

Bazuar në Nenin 59 të LPP-së, paragrafi 4, ku thuhet: *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.... sqarojmë se nuk janë plotësuar kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit.*

Ndërsa, lidhur me pikat tjera të cilat nuk ka informatë në katalogun e dorëzuar, sqarojmë se AK në njoftim për kontratë dhe Dosjen e Tenderit tek kapacitetit teknik dhe profesional ka parashtruar kërkesën numër 2: *Prezantimi i produkteve të ofruara me katalogë/broshura*, dhe dëshminë dokumentare 2: *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë, tek AK katalogë/broshura nga prodhuesi i këtyre furnizimeve për produkte të ofruar duke e nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike.* Në broshurën apo katalogun e dorëzuar nga O.E, për produktin e ofruar, nuk ka përshkrim të karakteristikave sikurse janë kërkuar në specifikimet teknike. Në një rast të tillë, Neni 28.

Sqarimi i Tenderëve, i RRUOPP – së e sqaron si në vijim: “Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu

(**“specifikimit teknik”** – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në raste kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar”, atëherë “Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm”

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit